

ANEKSI 9

Granti i Performancës për bashkitë

1. **Granti i Performancës** është një mekanizëm financiar që mbështet bashkitë të cilat performojnë më mirë.
2. Qëllimi i Grantit të Performancës, është të nxisë bashkitë të përmirësojnë proceset e qeverisjes në nivel vendor, që së bashku me kornizën e përmirësuar të politikave, të çojë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Ky fond akordohet bazuar në kritere performance duke ofruar incentiva për bashkitë për të përmirësuar performancën e tyre.
3. Granti i Performancës është një mekanizëm i bashkëfinancuar nga Qeveria Shqiptare dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar në marrëveshjen e bashkëfirmosur nga të dy palët sipas VKM Nr. 311, datë 22.05.2024 “Për miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për Projektin “Bashki të Forta (BTF), Faza 2”.
4. Për vitin 2025, fondi për grantin e performancës që do të finanohet nga Qeveria Shqiptare është në masën 200 milionë lekë, si zë i veçantë i fondit të akorduar për buxhetin vendor si transfertë e pakushtëzuar sektoriale.
5. Pjesa e bashkëfinancimit nga Qeveria Zvicerane dhe donatorë të tjerë i nënshtrohet skemës së plotë të thesarit, sipas përcaktimeve të Udhëzimit nr.10 datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.
6. Kriteret, procedurat dhe treguesit e performancës që do të përdoren për akordimin dhe shpërndarjen e këtij fondi, si dhe të drejtat e donatorëve do të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për pushtetin vendor.
7. Subjektet përfituese dhe zbatuese të këtij fondi janë bashkitë.